



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 928/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtaret Muhamet Rexha kryesues, Ymer Hoxha dhe Nenad Lazić anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega Vushtrri, paraqitur kundër Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ) lidhur me mospërputhjet e rezultateve nga Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), në seancën e panelit të mbajtur me 18.11.2013, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega Vushtrri,

Arsyetim

PZAP-i, me datën 15.11.2013 ka pranuar një ankesë nga subjekti politik LDK, në të cilën thekson se në disa Qendra të Votimit në komunën e Vushtrisë ka mospërputhje të rezultateve në mes të rezultateve të dhëna nga KKZ dhe KQZ. Sipas parashtruesit të ankesës në QV 2725B/01D në Zhilivodë të dhënat nga KQZ nuk puthen me ato që i kanë sjellë vëzhguesit gjë që i bënë dyshojnë se ka pasur manipulime gjatë plotësimit të formular.

Në QV 2710B/02R në Stanovc i Epërm ka vërejtje në procesin e numërimit të votave të kandidatëve për kryetar komune.

Në QV 2713B/04R në Smrekonicë kanë të dhëna kundërthënëse nga ana e vëzhguesve dhe rezultati i KQZ-se për këtë VV.

Në QV 2727B/02D në Shtruhërë ka pasur informata se është manipuluar procesi i numërimit të votave.

Në QV 2715B/01D në Gojbule dyshohet se është votuar edhe për kryetar edhe pse aty shumica e votuesve nuk kanë votuar për kryetar sepse VV ka qenë i serbëve.

Në QV 2719B/01D në Gracë dyshohet se është votuar edhe për kryetar edhe pse aty shumica e votuesve nuk kanë votuar për kryetar sepse VV ka qenë i serbëve.

Në QV 2716 në VV 01R,02R dhe 03D dyshohet se është votuar edhe për kryetar edhe pse shumica e votuesve nuk kanë votuar për kryetar sepse VV ka qenë i serbëve.

PZAP-i me datën 16.11.2013 ka kërkuar nga KQZ tërë materialin zgjedhor si Listën përfundimtare të votuesve, Formularët e Përputhjes së Rezultateve (FPR), Formularët e Rezultateve të Kandidatëve (FRK) dhe Librin e Vërejtjeve, për këto qendra të votimit lidhur me pa rregulluesit e pretenduara, andaj PZAP-i në bazë të nenit 117.2 dhe 117.4 si dhe të LZP-së ka shqyrtuar dhe hetuar materialin zgjedhor dhe pretendimet ankimore, provat që gjenden në shkresat e lëndës dhe pas vlerësimit të secilës provë veç e veç e në lidhshmërinë si dhe duke u bazuar në rezultatin e tërësishëm të provave të administruara ka gjetur se:

Ankesa është e pabazuar

PZAP-i, konstatoi se ankesa është e pa bazuara pasi që në bazë të hetimit dhe shqyrtimit të materialit zgjedhor si dhe në bazë të pretendimeve ankimore nuk ka gjetur prova të besueshme që do ti vërtetonin pretendimet ankimore të parashtruara në ankesë, andaj një pretendim i tillë i është i pabazë dhe i pa argumentuar mirë në prova dhe në dëshmi bindëse, andaj duke u bazuar nenin 118.1 të LZP-së, e vendos si në dispozitivë të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 928/2013 më datën 18.11.2013

**Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha**



Këshillë juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.